

**STATUT - AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ ALVA SOLAR ” SHPK**

Ne Tirane, sot me datën 27.12.2022 (dy mijë e njëzet e dy)

**PJESA E PARE  
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1  
Ortaku Themelues**

1.1 Shoqëria themelohet nga dy Ortake si më poshtë:

- a) Ne Tirane, sot me datën 27.12.2022 (dy mijë e njëzet e dy) shtetasi **Anduen Mbrice** i biri i Kristaq i datelindjes 03.09.1984 lindur ne kucove dhe banues ne Tirane ne adresën Laprake, Nd Lim-Em nr 13, Tirane, Kodi postar 1026.  
Me vullnet te lire te plote si themelues i kësaj shoqërie vendosi te hartoje ketë STATUT e AKT THEMELIMI mbështetur ne nenet e mëposhtme si dhe ne dispozitat ligjore si:  
Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne Fuqi, Ligjin me nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret e Shoqëritë Tregtare”.
- b) Ne Tirane, sot me datën 27.12.2022 (dy mijë e njëzet e dy) shtetasi **Vangjush Mbrice** i biri i Kristaq i datelindjes 18.10.1982 lindur ne kucove dhe banues ne Tirane ne adresën Laprake, Nd Lim-Em nr 14, Tirane, Kodi postar 1026.  
Me vullnet te lire te plote si themelues i kësaj shoqërie vendosi te hartoje ketë STATUT e AKT THEMELIMI mbështetur ne nenet e mëposhtme si dhe ne dispozitat ligjore si:  
Ne Kushtetutën e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil ne Fuqi, Ligjin me nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtaret e Shoqëritë Tregtare”.

**Neni 2  
Emri**

2.1 Emri i shoqërisë është “ **ALVA SOLAR**” SHPK (më poshtë referuar si “Shoqëria”)

**Neni 3  
Selia e Shoqërisë**

**3 Selia e Shoqërisë është: RRUGA E FSHATRAVE TURISTIKE ZONA KADASTRALE 3101 PASURI 1/780 QERRET ,GOLEM KAVAJE**

- 3.1 Shoqëria mund të hapë degë, përfaqësi, fabrika, zyra dhe njësi në çdo vend brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe do të zbatojë procedurat përkatëse ligjore dhe të regjistrimit.

**Neni 4  
Forma ligjore**

- 4.1 Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

**Neni 5  
Kohëzgjatja**

- 5.1 Shoqëria krijohet për një afat PA AFAT.

**Neni 6  
Objekti i Shoqërisë**

- 6.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:  
Për të gjitha llojet e projekteve dhe punimeve të ndërtimit të parashikuara për tu licencuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ( Emërtimi i Ministrisë varion sipas ndryshimeve që pëson më vonë), konkretisht: Ne fushën e ndërtimeve civile, industriale ,turistike, bujqësore, etj. Kompletimi dhe instalimet e nevojshme për to, rikonstruksione godina civile ekonomike, veshje fasadash, ndërtim rrugësh, vepra arti rrugore, punime hidroteknike, ujësjellësa e kanalizime, punime restaurimi , punime karpenterie, punime e shërbime të sistemit komunal, punime mirëmbajtje , prodhim elementesh parafabrikate e beton arme, mirëmbajtje dhe zhvillim dekori, punime gjeodezike ne objekte inxhinierie, punime speciale gjeodezike, rlevime topografike, etj. Import Export. Me pakice dhe shumice të mallrave të ndryshme të lendeve të pare të ndërtimit dhe prodhimeve, ngritje pike servisi të automjeteve .Studim - Projektim, Konsulence Teknike. Studim, projektim, për ndërtim e zbatim të veprave ndërtimore të të gjitha llojeve sipas legjislacionit shqiptar. Studime urbanistike të të gjitha llojeve e masterplane. Shërbime ne planifikim urban. Projektim, ndërtim, montim, zbatim e rikonstruksion të godinave të të gjitha llojeve, rruge të çdo kategorie, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaji, metro, pista aeroportuale, punime nëntokësorë, ura e vepra arti, ujësjellësi, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, ndërtime hidroteknike, mbrojtje lumore, sistemime hidraulike e bonifikime, barriera dhe mbrojtje lumore diga, damba, tunele. Ndërtime stacione elektrike. linja të tensionit të lartë, të ulët e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë. Ndërtim impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri e mirëmbajtjen e tyre. Impiante ngritëse transportuese. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike e druri. Impiante teknologjike, termike e kondicinimi. Impiante e linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impiante të brendshëm

elektrike, telefonike radiotelefoni etj. Impiante te sinjalistikës rrugore te trafikut, sinjalistika rrugore jo ndriçuese. Investime ne ndërtime civile, pallate ne ndërtime turistike. Hapjen e agjencive imobiliare. Transport mallrash e udhëtaresh e pika servisi për automjete. Import-eksport sipas legjislacionit. Ndërmarrje ndërtimi për vete dhe për te trete ne kryerjen e veprimtarive ndërtimore, ndërtime civile, industriale, bujqësore turistike dhe kompletimi me instalimet elektrike, elektronike etj, qe lidhen me to.

Prodhim energjie me te gjitha mënyrat e mundshme bashkëkohore, Instalimin dhe Lidhjen, shpërndarjen. Shfrytëzim minerar dhe shitje e mineraleve dhe përpunim artizanal i gurëve dekorative dhe fasoneve dhe shitja e tyre. Rilevime gjeologjike për kërkim –zbulim. Studio për punime topografie makshederie. Studio për ekspert kontabël, ose kontabël i miratuar. Tregtim me pakice te hidrokarbureve. Tregtim me shumicë dhe pakicë import eksport i artikujve të ndryshëm industrial kancelari dhe artikuj shkollor etj, i artikujve ushqimor, hidrosanitare, goma makinash, elektroshtëpiake, elektrike, konfeksione e tekstile, makineri e pajisje. Hapje rrobaqepësie. Tregtim me shumicë dhe pakicë, eksport-import i produkteve dhe nënprodukteve bujqësore dhe blegtorale, përpunim dhe ambalazhim i tyre, ushqimeve për blegtorinë, farërave, fidanëve, plehra kimike, makineri bujqësore e blegtorale , bimë mjekesore. Bar kafe dhe restaurant. Shfrytëzim i kulturës ujore, florës dhe faunës.. Tregtim me shumicë dhe pakicë import eksport i duraluminit, dhe produkteve të gatshme apo gjysme të gatshme të duraluminit. Prodhim dhe tregtim i lëkurëve e prodhimeve të tjera si çanta ,këpucë etj. Prodhim e tregtim e ambalazhim i mishit dhe formave të ndryshme të përpunimit të tij. Tregtim me pakicë import eksport i hidrokarbureve, karburanteve dhe gazit natyror për ngrohje , gatim dhe lëndë djegëse për automjetet si dhe të gazit të lëngët. Hapje pikë karburanti me pakicë (stacion distributor). Ndërtime, studime, projektme dhe investimeve në mjedis, turizëm dhe pyje. Mbarështim i pyjeve, prerja ,përpunimi dhe tregtim me shumicë dhe pakicë import eksport i lëndës drusore. Tregtim i pjesëve të këmbimit për autovetura, mjete transporti, tapiceri, etj. Shfrytëzim terrenesh sportive siç janë fushat për ushtrimin e sporteve të ndryshme, ngritje dhe shfrytëzim palestrash etj. Salla lojërash për fëmijë. Ngritjen e qendrave të informimit dhe shërbimit për turizëm, mjedis. Pastrim i mbeturinave inerte urbane dhe i plehrave të qytetit. Ngritja e fidanishteve dhe serave të luleve, për prodhimin dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë, import eksport i frutave të njoma, e të thata, pemëve frutore, dekorative dhe ambalazhim i tyre. Prodhim dhe përpunim e tregtim me shumicë dhe pakicë import eksport i duhanit ne të gjitha format e përpunimit të tij dhe ambalazhim i produkteve të tij. Prodhim e tregtim me shumicë dhe pakicë i konfeksioneve të ndryshme të gatshme dhe gjysmë të gatshme, blerjen e lëndës së tyre të parë, ndihmëse, si dhe teknologji dhe pajisje si dhe ambalazhimi dhe stampimi i tyre .

Prodhim shitje energjie e rinovueshme e prodhurar nga panale diellor fotovoltaiik ,Hec dhe cdo lloje energjie qe prodhohet . Tregtimi dhe prodhimi i materialeve të ndërtimit( inerte, çimento, llaç, gëlqere, pllaka, tjegulla, tulla, bllaqe, skele, armatura e gjithshka lidhet me ndërtimin Autoshkollë, Agjenci e transportit te pasagjerëve dhe të mallrave dhe transport i tyre , taksi shërbime urbane interurbane, transpedicion, Studio arkitektonike për punimet arkitekturore , urbanistike , Dhënie me qira e objekteve për përdorim personal ose shtëpiak ,

ndërmjetësim në shitjen e makinerive dhe pajisjeve industriale. Ndërmjetësim në shitjen e specializuar të produkteve të veçanta apo i pasurive të paluajtshme. Shoqëria do të ketë mundësi, gjithashtu, të kryejë të gjitha operacionet tregtarë, ekonomike, industriale, në fushën e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe financiare që kanë lidhje të ngushtë me objektin shoqëror dhe të nevojshme ose të dobishme për përmbushjen e këtij objekti, në mënyrë që të përputhen me objektin e aktivitetit duke përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen e shoqërisë në shoqëri me objekt të njëjtë ose të përafërt.

## **PJESA II KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË DHE KUOTAT**

### **Neni 7 Kapitali i Shoqërisë**

- 7.1 Kapitali fillestar i Shoqërisë është 100.000 ( njëqind mijë) Leke.
- 7.2 Kapitali i cili është shlyer tërësisht. i gjithë kapitali është ndarë në 2 kuota, ku vlera nominale e një kuote është 50 000 ( pesedhjetë njëmijë) lekë për ortakun Anduen Mbrice dhe 50 000 ( pesedhjetë njëmijë) lekë për ortakun Vangjush Mbrice.

---

## **III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKUT TË VETËM**

### **Neni 8 Përgjegjësia e kufizuar**

- 8.1 Ortaket kanë pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

### **Neni 9 E drejta e pjesëmarrjes në mbledhjet e Asamblesë**

- 9.1 Ortaket kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrjen e Shoqërisë në mbledhjet e Shoqërisë.

### **Neni 10 Detyrimet e Ortakut**

- 10.1 Ortaku ka detyrim të mbështesë Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përmbushin vendimet e mbledhjes së ortakut dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrë të duhur brenda qëllimit të organit përkatës.

**Neni 11**  
**KUSHTET EKONOMIKE**

- 11.1 Shoqëria hap llogari bankare ne leke vendi dhe çdo lloj valute, ne Banka vendase ose te huaja, private apo shtetërore, me qellim për te kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar te aktivitetit te saj. Ortaket depozitojnë faksimilet e firmave te tyre origjinale ne Bankat ku është hapur llogaria.
- 11.2 Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie sipas Kodit Civil, te shiten apo te dhurohen sipas ligjeve ne fuqi. Ortaket kane te drejte te transferojnë jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e tyre e përfshire dhe fondet dhe kontributet e pjesëve te kapitalit themelor, duhet te jene te vërtetuara me Akt Noterial dhe për një gjë te tille vendimet e asamblesë se ortakeve te shoqërisë duhet te merren paraprakisht me shkrim. Shoqëria dhe te tretet duhet te respektojnë këto transferime sapo t'u behën te ditura.
- 11.3 Me vendim te ortakeve shoqëria mund te zgjeroje aktivitetin e saj tregtar dhe ne drejtime te tjera janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.
- 11.4 Shoqëria mund te zgjerohet duke pranuar ortake te tjerë, shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit. Ajo mund te hape filiale dhe seli ne vende te ndryshme brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**PJESA IV**  
**ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE DHE TE DREJTAT DHE DETYRAT**  
**E ORTAKEVE TE SHOQERISE**

**Neni 12**  
**Të drejtat e asamblesë**

- 12.1 Asambleja është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj ne përputhje me kompetencat sipas ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët e Shoqëritë Tregtare”. Asambleja e ortakeve mund t’ia delegeje kompetencat një ose me shume administratoreve te caktuar prej saj dhe një personi fizik jashtë ortakërisë se shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.
- 12.2 Me vendim te Asamblesë se Ortakeve, mund te krijohen ose anulohen (ne rast se janë çelur) seli, filiale, agjenci dhe përfaqësi si ne qytete te tjera te Shqipërisë dhe jashtë saj. Njësite e tjera strukturore te shoqërisë si Dege apo përfaqësi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë te tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve te huaja, normat e se drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit.
- 12.3 Shoqëria e fiton personalitetit e saj juridik nga data e regjistrimit ne QKB, për njohjen dhe regjistrimin e saj si person juridik ne Regjistrin Tregtar.

Ushtrimin e Aktivitetit tregtar e fillon pasi te jete reregjistruar dhe pajisur me certifikate perkatëse ne Organin e Tatim Taksave Tirane.

12.4 Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj ne përputhje te plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit te veprimtarisë se saj, mbi bazën e Aktit te Themelimit dhe Statutit te saj dhe normat e se drejtës tregtare ndërkombëtare.

12.5 Vetëm asambleja e ortaku i vetëm ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.
- n) Te lidhi kontrata te ndryshme qe kane për objekt blerjen, shitjen, këmbimin, marrjen me qira te pasurive te ndryshme (te luajtshme apo te paluajtshme), si me persona fizik dhe ata juridik vendas apo te huaj si dhe me shtetin dhe ne rast te blerjes se pasurive te paluajtshme, te bëjnë dhe transkriptimin e pronësisë se saj ne favorin e tyre ne Hipotekën e ZRPP, për te dokumentuar një rrethane te tille dhe si shtese te kapitalit ne natyre.
- o) Te kryeje çdo lloj veprimi pranë te gjitha zyrave private dhe Shtetërore, Bankat e çdo niveli etj. qe kane te bëjnë me Garancitë, sipërmarrjet, marrjen e kredive, siguracione, transporti (brenda dhe jashtë vendit), për zhdoganimin e mallrave te importuara apo eksportuara, atë te plotësimit me korrekte te dokumentacionit fiskal e tatimor etj. e shlyerjes ne kohe te çdo detyrimi. Ne rastet kur këto veprime juridike kryhen nga administratori i emëruar nga ortaku i vetëm ose personi qe e përfaqëson atë mbi bazën e prokurës, këta ne përfundim te realizimit te veprimit perkatës detyrohen qe te njoftojnë menjëherë dhe t'i japin llogari ortakut te vetëm.

- p) Administratori ose përfaqësuesi me prokure janë individualisht përgjegjës ndaj shoqërisë apo te treteve, për veprime te kryera ne shkelje te ligjeve dhe qe bien ne kundërshtim me ketë Statut dhe për demin e shkaktuar me faj, sipas rastit. Ortaku mund te ngrrejë dhe te kërkojë ndaj tyre padi për shlyerjen e demit civil, duke përfshire dhe te drejtën për te bere kallëzim për ndjekje penale ne Prokurorinë e juridiksionit tokësor ku ka selinë shoqëria.
- q) Përfaqësimi i shoqërisë ne marrëdhëniet me te tretet si brenda dhe jashtë shtetit si rregull dhe përgjithshëm i përket Administratorit te shoqërisë.
- r) Asambleja e Ortakeve dhe Administratori i shoqërisë, ka te drejte qe për nevojat e ushtrimit normal te aktivitetit te shoqërisë, te marrin ne pune shtetas te ndryshëm, madhor dhe me zotësi te plote për te vepruar, duke lidhur kontrate sipas kriterëve qe parashikohen ne Kodin e Ri te Punës ne fuqi dhe me ligjin nr. 7703. dt 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore “ te ndryshuar si dhe ne përshtatje me rregullat e brendshme te disiplinës teknike dhe te punës te caktuar nga vete punëdhënësi.

12.6 Në çdo rast asambleja e ortaku i vetëm do të ketë të drejtë të vendosë mbi çdo çështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm të shoqërisë.

### **Neni 13**

#### **Thirrja e asamblesë së ortaku i vetëm**

13.1 Asambleja e ortaku i vetëm do të thirret nga administratori të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne çdo vend tjetër nëse përcaktohet ne njoftim.

### **Neni 14**

#### **Procesverbali i mbledhjes së ortaku i vetëm**

14.1 Për çdo mbledhje të asamblesë , ortaku i vetëm do të mbajë një procesverbal dhe do të merren vendime. Procesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregtar . Procesverbalit i bashkëngjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

14.2 Procesverbali do të firmoset nga kryetari dhe kundërfirmoset nga sekretari që e mban atë.

14.3 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesverbalit dhe shpërndarjen e tij.

## **PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

## Neni 15 Administrimi i Shoqërisë

- 15.0 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga administratori **Anduen Mbrice** lindur me **03.09.1984 ne Kucove**, banuese ne Tirane me nr ID **I40903093I** e cili emërohet për një periudhë **5 (pese) vjeçare** me te drejte rinovimi dhe miratim e saj nga asambleja cdo fund viti kalendarik.  
Administratori mund të autorizojë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të veçanta (banka, noter, institucione te ndryshme etj).
- 15.1 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 15.2 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e ortaku i vetëm dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 15.3 Administratori ka të drejtat e mëposhtme:
- (a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - (b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
  - (c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - (d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - (e) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - (f) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - (g) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 15.4 **Anduen Mbrice** caktohet administrator i shoqërisë për një periudhë 5 (pese) vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje

## PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJE

### Neni 16 Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

- 16.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë

fillojnë datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

- 16.2 Në fund të çdo viti financiar, administratori do të përmbushë detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
  - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
  - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 16.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakut të vetëm së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

#### **Neni 17 Fitimi i Shoqërisë**

- 17.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakut të vetëm dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

### **PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

#### **Neni 18 Prishja dhe likuidimi**

- 18.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:
- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakut të vetëm;
  - (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
  - (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
  - (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 18.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

### **PJESA VIII TE PËRGJITHSHME**

#### **Neni 19 Te përgjithshme**

- 19.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortaku i vetëm do të përpiqet t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 19.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 19.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale .

### ORTAKET

ANDUEN MBRICE

VANGJUSH MBRICE